



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.202/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesues, Skender Çoçaj dhe Arsim Hamzaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit të Organizatave Joqeveritare Avonet, me seli në Ferizaj, paraqitur kundër Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më 15.10.2025, merr këtë,

:

VE N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e Rrjetit të Organizatave Joqeveritare Avonet, me seli në Ferizaj, ZL.Anr.202/2025 e datës 13.10.2025.

II. Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë Fushatës Zgjedhore për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, i shqiptohet dënimi më gjorbë në lartësi prej 1.500.00 (njemijëepeseqind) euro.

III. Detyrohet Subjektit Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, që gjorbën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 13.10.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë përmes postes, nga Rrjeti i Organizatave Joqeveritare Avonet, me seli në Ferizaj, me të cilën pretendon se më datë 08 Tetor 2025, Zekir Bytyqi, kandidatë për Kuvendin e Komunës së Ferizajt, nga radhët e AAK-së, për shkak se i njëjti me veprimet e tij ka shkelur normën e nenit 34 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, lidhur me normën e nenit 7, paragrafit 2, nën paragrafit 2.9. të Rregullores Zgjedhore nr. 07/2014, për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, për faktin se i njëjti ka vendosur postera me përmbajtje elektorale shumë afër

Qendrës së Votimit, rreth 15 metra afër Qendrës së Votimit në fshatin Mirosalë, të quajtur Mejdi Xhaferi. Pra, ky kandidat nuk ka respektuar përkufizimin e paraparë në Rregulloren Zgjedhore nr. 07/2014, për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, se nuk mund të vendosen postera në afërsi të Qendrave të Votimit deri në 100 metra.

Parashtruesi i ankesës thekson se në rastin konkret posteri është vendosur jo më larg se 15m, sipas kësaj përllogaritje: 3m trotuari, 6m rruga, 6 m pjesa tjetër. Në këtë drejtim, parashtruesi i ankesës kërkon që duke u mbështetur në autorizimet dhe kompetencat e juaja ligjore të e trajtoni këtë ankesë duke përfshirë edhe shqiptimin e masave të nevojshme dhe proporcionale në raport me peshën, formën dhe mënyrën e kryerjes së kësaj shkelje të rregullores në fjalë nga ana e kandidatit të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovë, për Kuvendin e Komunës së Ferizajt, Zekir Bytyqi. Si provë parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa Fotografii që dëshmojnë vendosjen e posterit të kandidatit të subjektit politik Aleancës për Ardhmërinë e Kosovë, për Kuvendin e Komunës së Ferizajt, Zekir Bytyqi.

Në përgjigjen në ankesë, subjekti politik AAK, kundërshton në tërësi pretendimet e Rrjetit të Organizatave Joqeveritare Avonet, duke i konsideruar ato të pabazuara. Në vazhdim të përgjigjes kanë sqaruar se përmes fotografive të bashkangjitura si provë, nuk mund të vërtetohen në asnjë mënyrë se objekti që shihet në fotografi është Qendra e Votimit në fshatin Mirosalë, dhe nuk mund të dëshmohet koha e saktë e kryerjes së shkeljes së pretenduar, për arsye se lidhur me pretendimin e ankuesit se objekti i paraqitur në fotografitë e bashkangjitura përfaqëson një Qendër të Votimit, subjekti politik AAK thekson se një pretendim i tillë nuk mbështetet në asnjë provë konkrete, se objekti në fjalë është Qendër e Votimit e caktuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ).

Në asnjërin nga fotot nuk shfaqet ndonjë tabelë emërtuese, mbishkrim zyrtar, emblemë e KQZ-së apo ndonjë element vizual dallues që do të mundësonte identifikimin e qartë të objektit si Qendër të Votimit. Tutje në përgjigje në ankesë theksohet se nga përmbajtja e vetë ankesës së paraqitur nga ankuesja nuk rezulton të jetë specifikuar as koha dhe as data kur ajo ka hasur me posterin e kandidatit z. Zekir Bytyqi, apo kur pretendohet se është kryer shkelja e supozuar zgjedhore.

Një mungesë e tillë e të dhënave thelbësore e bën të pamundur verifikimin e afatshmërisë së ankesës, pasi sipas nenit 39, par. 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej 48 orësh nga momenti kur është kryer shkelja e pretenduar, theksohet në përgjigjen në ankesë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli, nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë ka konstatuar se kandidati për Kuvendin e Komunës së Ferizajt, nga radhët e AAK-së, Zekir Bytyqi, ka vendosur poster në afërsi të Qendrës së Votimit Mejdi Xhaferi, në fshatin Mirosalë, Komuna e Ferizajt, me të cilin veprim ka bërë shkelje të nenit 34, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës LJP, konkretisht neni 34, paragrafi 1 nën paragrafi

1.2 i LZP-së parasheh: "1. Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.2 vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe posterëve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugët publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa leje e pronarëve ose shfrytëzuesve", si dhe Rregullores Zgjedhore Nr.07/2014, për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, nenit 7, paragrafit 2, nën paragrafit 2.9, i cili parasheh: "Materiali i subjekteve politike nuk duhet të vendoset, si në vijim", "brenda qendrave të votimit, ose në një largësi prej më pak se njëqind (100) metra nga hyrja e tyre",

Neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, thekson se në rast se PZAP, përcakton se ka ndodhur shkelje e të këtij ligji ose e rregullave të KQZ-së, mundet të vendosë një gjobë ndaj një subjekti politik, në vlerë deri në pesëdhjetëmijë (50,000.00) Euro.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se veprimi që përben përsëritje të shkeljes për nga natyra është i njëjtë apo ngjashëm, subjektit politik që ka bërë shkelje të legjislacionit zgjedhor, apo ka bërë shkelje të legjislacionit edhe në proceset e mëparshme zgjedhore, që konsiston në faktin se subjekti politik AAK, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 118 paragrafi 1, neni 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, nenit 10 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Rregullores Nr.01/2025, për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.202/2025, datë 15.10.2025

Kryesuese e Panelit
Kymete Kicaj



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 paragrafi. 4 të LZP-së.